



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:251511

Datë: 07.12.2021

Numri i dokumentit: 02478083

C.nr.1020/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen juridike të paditësit N. K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, në seancën e datës **07.12.2021**, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET se është tërhequr padia e paditësit N. K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës, në këtë çështje juridiko kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi N. K. nga fshati M., Komuna e Prishtinës, pranë kësaj gjykate me datë 22.02.2013 ka parashtruar padi për kompensim dëmi, kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës me seli në Prishtinë.

Në seancën e datës 07.12.2021, paditësi e ka njoftuar gjykatën se në këtë çështje kontestimore e tërheq padinë kundër të paditurës Qeveria e Kosovës - Ministria e Infrastrukturës, për kompensim dëmi.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi, konform nenit 261.1, në lidhje me nenin 261.3 dhe 387.1 (c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK).

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË -
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.1020/18, me datë 07.12.2021**

**Gjyqtari,
Dren Rogova**

KËSHILLË JURIDIKE: Bazuar në nenin 261.4 të LPK-së, kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.